

STATUT E AKT-THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ THE PINT ” SH.P.K

Liridjon Nazarko i biri i Alfredit banues ne Tirane Rr.”Vedat Kokona” Nd. 12 , Hyrja 1 , mbajtes i numrit te identifikimit **I70413075U** i datelindjes 13/04/1987 madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar

Dhe ,

Erjon Ramaj i biri i Pellumbit , banues ne Tirane Rr.”Loni Ligori” ,Shkalla. 1 , Apartamenti. 29 mbajtes i numrit te identifikimit **I70630071K** I datelindjes 30/06/1987 madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar

Deklarojne ne kete Akt – Themelimi e Statut si me poshte :

NENI 1

Mbeshtetur ne legjislacionin Shqiptar ne pergjithesi dhe ligjin 9901 dt.14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” sot me **dt:07/11/2023** ortaket kane vendosur qe kjo shoqeri te marre formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me dispozitat ligjore si me sipër si dhe te statutit qe i bashkengjitet ketij akt-themelimi

NENI 2

Emertimi i shoqerise eshte “ THE PINT ” Sh.p.k

NENI 3


Selia e shoqerise

Shoqeria “ The Pint ” Shpk do ta kete seline e saj ne **Tirane , Rr. Qemal Stafa , Pallati. 19 , Shkalla. 4, Kati. 1 , Apartamenti. 31 , zona kadastrale 8170** por me vendimin e ortakeve mund te ngrihen edhe dege , filiale apo seli ne vende te tjera Brenda dhe jashte shtetit Shqiptar

NENI 4

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar



NENI 5

Objekti I veprimtarise

Objekti i veprimtarise do te jete :

Bar-restorant , piceri , grill , delivery (shperndarje ushqimesh dere me dere) , organizim eventesh

Me zgjerimin e aktivitetit shoqeria shpk mund te beje ndryshime te objektit te veprimtarise se saj , duke bere ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise .

NENI 6

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise do te jete 100 000 leke i ndare ne 2 kuota :

Liridjon Nazarko 50 000 leke 1 kuote 50 %

Erjon Ramaj 50 000 leke 1 kuote 50 %

NENI 7

Shlyerja e kapitalit themeltar te shoqerise

Mbeshtetur ne ligjin nr.9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe me ndryshimet e bera , shlyerja e kapitalit do te kryhet pjese pjese nga ortaket e shoqerise . Modalitetet dhe afatet e shlyerjes se kapitalit percaktohen me vendim te asamblese se ortakeve .

NENI 8

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise mund te behet nepermjet nenshkrimeve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre nepermjet emerimit nga gjykata kompetente te nje eksperti te autorizuar sipas kerkeses se administratorit.Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e shoqerise .

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve , e cila merr vendimin ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i kapitalit prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne .

NENI 9

Transferimi I kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo mund te kalohen nepermjet :

- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- Shitblerjes
- Dhurimit
- Trashegimise
- Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve , per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme nepermjet trashegimise .

NENI 10

Organet vendimarrrese

Asambleja e ortakeve eshte i vetmi organ vendimarrres i shoqerise .

Asambleja e ortakeve eshte i vetmi organ vendimarrres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj .

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjitheshme , ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nje person i trete .

NENI 11

Administrimi

Asambleja e pergjithshme emerion administrator te shoqerise Z . Liridjon Nazarko i biri i Alfredit , lindur me 13/04/1987 ne Erseke dhe banues ne Tirane , mbajtes i numrit te identifikimit I70413075U.

Afati i emerimit eshte 5 vjet sipas nenit 95 te ligjit 9901 dt.14/04/2008 “per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ndryshimet e bera .

NENI 12

E gjithe veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne legjislacionin ne pergjithesi te Republikes se Shqiperise si dhe ligjin 9901 dt.14/04/2008 “per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

NENI 13

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

1. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj .
2. Me vendim te asamblese se ortakeve .
3. Me hapjen e procedurave te falimentimit .
4. Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr 9723 , date. 03/05/2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”
5. Me vendim te gjykates

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise , duke caktuar 1 apo disa likujdator dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën “shoqeri ne likujdim e siper”

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese , me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi .

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket .

NENI 14

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti , si dhe per mosmarreveshje qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve , do te jete kompetente Gjykata Rrethit Gjyqesor Tirane .

Ky akt themelimi e statut u nenshkrua sot me 07/11/2023

ORTAKET

**E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “THE PINT” SHPK
PERFAQESUAR NGA :**

LIRIDJON NAZARKO



ERJON RAMAJ

